



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT  
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE  
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Cabinet of the Minister

Kabinet Ministra

## UDHËZIM ADMINISTRATIV

### Mbikëqyrja profesionale pedagogjike e punës së edukatoreve dhe bashkëpunëtorëve profesional

**NUMËR: 40/2007**

**DATË : 9.10. 2007**

Në bazë të nenit 1.3 pika ( d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, neni 25 paragrafi 7 i Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, neni 38 pika 3 dhe 4 të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më poshtë MASHT) nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

#### Neni 1

##### Qëllimi

Ky Udhëzim administrativ ka për qëllim të rregulloj mënyrën e mbikëqyrjes profesionale pedagogjike të punës së edukatoreve dhe bashkëpunëtorëve profesional në institucione parashkollore publike dhe private.

#### Neni 2

##### Llojet e mbikëqyrjes

Llojet e mbikëqyrjes profesionale pedagogjike janë:

- a) informative,
- b) të përgjithshme,

- c) të ngushta profesionale dhe
- d) speciale.

### **Neni 3**

#### **Mbikëqyrja profesionale pedagogjike**

1. Mbikëqyrja profesionale pedagogjike e punës së edukatoreve dhe bashkëpunëtorëve tjerë profesional, bëhet nga mbikëqyrës profesional pedagogjik, që kanë përgatitje adekuate profesionale pedagogjike dhe që janë të autorizuar nga MASHT-i.
2. Mbikëqyrja profesionale pedagogjike bëhet me paralajmërim dhe pa paralajmërim.
3. MASHT bën mbikëqyrjen profesionale pedagogjike edhe me përfaqësues nga DKA sipas nevojës.
4. Mbikëqyrja profesionale pedagogjike e institucionit parashkollor (IP) bëhet sipas nevojës.

### **Neni 4**

#### **Konstatimi i gjendjes**

1. Mbikëqyrja profesionale pedagogjike bëhet me paralajmërim, pa paralajmërim dhe me kërkesë.
2. Mbikëqyrja me paralajmërim bëhet atëherë kur IP njoftohet paraprakisht për kohën e mbikëqyrjes pedagogjike.
3. Mbikëqyrja pa paralajmërim ka për qëllim konstatimin e gjendjes faktike të punës së përditshme edukative në institucionin parashkollor (IP) përkatës.
4. Mbikëqyrja profesionale pedagogjike bëhet me kërkesë të drejtorit, edukatoreve, si dhe prindërve, me qëllim të ndihmës profesionale, apo të evitimit të dobësive ekzistuese.

### **Neni 5**

#### **Raporti**

Pas çdo mbikëqyrje profesionale, sipas paragrafeve 1, 2, 3, 4 të nenit 4, bëhet raporti me rekomandime dhe nga një ekzemplar u dorëzohet:

- a) Institucionit parashkollor( IP) përkatës,
- b) DKA-së dhe
- c) MASHT-njësia për Edukim Parashkollor.

## **Neni 6**

### **Rekomandimet**

1. Nëse gjatë mbikëqyrjes profesionale konstatohen parregullsi në veprimtarinë edukative, mbikëqyrësi i rekomandon drejtorit të IP t'i korrigjojë parregullsitë e caktuara.
2. Për korrigjimin e dobësive, caktohet afati kohor, varësisht prej natyrës së parregullsive, duke i dhënë vërejtje me gojë dhe me shkrim.
3. Drejtori i IP obligohet që për parregullsitë e evituara ta informoj me shkrim mbikëqyrësin.

## **Neni 7**

1. Nëse edukatori-bashkëpunëtori profesional nuk e korrigjon punën e vet edukative arsimore edhe pas vërejtjeve paraprake deri në afatin e caktuar, mbikëqyrësi ka për detyrë ti rekomandoj drejtorit të IP përkatës që të fillojë procedurën disiplinore ndaj edukatorit-bashkëpunëtorit profesional të IP përkatës.
2. Nëse drejtori i IP përkatës nuk merr masa sipas rekomandimit të mbikëqyrësit, atëherë MASHT duhet të marrë masa përkatëse ndaj drejtorit në fjalë.
3. Nëse drejtori i IP përkatës nuk merr masa sipas rekomandimeve të mbikëqyrësit, atëherë MASHT ngrit procedurën disiplinore ndaj tij.

## **Neni 8**

### **Ndërprerja e punës dhe alternativat**

Nëse mbikëqyrësi konstaton se edukatori i caktuar, me punën e vet krijon shqetësime të fëmija-fëmijët, ai duhet ta ndërprejë punën edukative me atë grup edukativ, për kohë të caktuar, e më së shumti për një javë, duke e propozuar njëkohësisht zgjidhjen alternative.

## **Neni 9**

### **Vendimi**

Masa e ndërmarrë sipas nenit 7, nga mbikëqyrësi është marrja e Vendimit, me të cilin duhet të njoftohet drejtori i IP përkatës dhe MASHT-i.

## **Neni 10**

### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

---

**Agim Veliu, ministër**